



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 14, DATË 20.02.2020

PËR

RINOVIMIN E AUTORIZIMIT TË SUBJEKTIT PERSON FIZIK BESIM SULA,
PËR PËRSËRITJEN E SHËRBIMIT TË PROGRAMIT AUDIOVIZIV TË TË
TRETËVE MBËSHTETUR NË RRJET KABLLOR "TV KABLLOR SULOVA" DHE
ZGJERIMIN E ZONËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMIT

Në mbështetje të nenit 55, pika 4/b të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve", miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017, si dhe pas shqyrtimit të aplikimit nr. 1787 prot., datë 25.04.2019 të subjektit person fizik Besim Sula dhe dokumentacionit plotësues për rinovimin e autorizimit për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Tv Kabllor Sulova" dhe zgjerimin e zonës së shërbimit, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

VENDOSI:

1. Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Besim Sula, me NIPT: L02906201A, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Tv Kabllor Sulova", me zonë ofrimi shërbimi "*Njësitë administrative Mollas dhe Gjergjan*", për një afat 5 (pesë) vjeçar.
2. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit person fizik Besim Sula, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Tv Kabllor Sulova" në "*Njësinë administrative Klos*".
3. Kushtet e autorizimit të subjektit person fizik Besim Sula, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Tv Kabllor Sulova", përveç zonës së ofrimit të shërbimit, mbeten të pandryshuara.
4. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim për pikën 1, i shtrin efektet prej datës 07.03.2019, ndërsa për pikën 2 hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:	Gentian	SALA
Zëvendëskryetar:	Sami	NEZAJ
Anëtarë:	Agron	GJEKMARKAJ
	Gledis	GJIPALI
	Suela	MUSTA